

Vendim I Këshillit të Administrimit i Shoqërisë "BLUE EYE WATER" sha

Vendimmarrja e mbledhjes së Këshillit të Administrimit të shoqërisë "Blue Eye Water" e datës 17.05.2018 e mbajtur në përputhje me parashikimet e nenit të statutit të shoqërisë, pasqyrohet në këtë dokument i cili nënshkruhet nga të gjithë Antarët e Këshillit të Administrimit.

Pjesëmarrës në mbledhje janë Anëtarët e Këshillit të Administrimit të shoqërisë:

- Donald Shena, shtetas shqiptar, në cilësinë Kryetarit të Këshillit të Administrimit i përfaqësuar në këtë mbledhje nga z.Thomas T. Prousalis Jr., shtetas American, sipas prokurës bashkëlidhur këtij dokumenti.
- John Alfred O'Brien, shtetas American, në cilësinë e anëtarit të këshillit të administrimit.
- Craig Francis White, shtetas American, në cilësinë e anëtarit të këshillit të administrimit.

Fillimisht u kontrollua vlefshmërinë e njoftimeve, autorizimeve dhe aftësinë e saj për të marrë vendime të vlefshme, pa ndonjë vërejtje në këtë drejtim.

Rendi i ditës së mbledhjes është si më poshtë vijon:

- Emërimin dhe të z.Bashkim Shalla në detyrën e Administratorit të shoqërisë së aksionerëve
- Emërimin e z.Bashkim Shalla në detyrën e Presidentit të shoqërisë së aksionerëve.

Këshilli i Administrimit, pasi u njoh me rendin e ditës, diskutoi rreth tij dhe nevojës që shoqëria ka për të përmirësuar ecurinë e punës së saj, dhe e gjen të arsyetuar nevojën e këtyre ndryshimeve, gjithashtu falenderon z.Bashkim Shalla për pranimin e detyrave të propozuar nga ky këshill.

Përfundimisht, Këshilli i Administrimit i Shoqërisë "BLUE EYE WATER",
unanimisht vendosi:

- Të emërojë në detyrën Administrator të kompanisë "Blue Eye Water" dhe z.Bashkim Shalla për një afat 3-vjeçar.
- Të emërojë në detyrën President të kompanisë "Blue Eye Water" z. Bashkim Shalla.

Amëtarët e Këshillit të Administrimit

Donald Shena (Kryetar Bordi). John Alfred O'Brien (Anëtar) Craig Francis White (Anëtar)
Përfaqësuar nga
Thomas T. Prousalis, Jr.

VENDIM I ASAMBLESË SË SHOQËRISË "BLUE EYE WATER" sha

Vendimmarrja e mbledhjes së shoqërisë aksionere "Blue Eye Water" e datës 17.05.2018 e mbajtur në përputhje me parashikimet e nenit të statutit të shoqërisë, pasqyrohet në këtë dokument i cili nënshkruhet nga të gjithë antarët e shoqërisë aksionere.

Pjesëmarrës në mbledhje janë Anëtarët e Asamblesë së shoqërisë:

- Donald Shena, shtetas shqiptar, në cilësinë Kryetarit të Këshillit të Administrimit i përfaqësuar në këtë mbledhje nga z. Thomas T. Prousalis ,Jr., shtetas American, sipas prokurës bashkëlidhur këtij dokumenti.
- American Capital Gruop shpk e përfaqësuar nga z. Donald Shena.

Fillimisht asambleja konstatoi vlefshmërinë e njoftimeve, autorizimeve dhe aftësinë e saj për të marrë vendime të vlefshme, pa ndonjë vërejtje në këtë drejtim.

Rendi i ditës së mbledhjes është si më poshtë vijon:

- Emërimin e z. Bashkim Shalla në detyrën e Antarit të Këshillit të Administrimit.

Asambleja e aksionerëve, pasi u njoh me rendin e ditës, diskutoi rreth tij dhe nevojës që shoqëria ka për të përmirësuar ecurinë e punës së saj, dhe e gjen të arsyetuar nevojën e këtyre ndryshimeve, gjithashtu falenderon z. Bashkim Shalla për pranimin e detyrës së propozuar si Anëtar i Këshillit të Administrimit.

PËRFUNDIMISHT, ASAMBLEJA E AKSIONERËVË TË SHOQËRISË "BLUE EYE WATER",
UNANIMISHT VENDOSI:

- Emërimin e z.Bashkim Shalla në detyrën e Antarit të kishillit të Administrimit për një periudhë kohore prej 3-vitesh.

Bordi i Aksionerëve

Donald Shena (Kryetar Bordi).

Përfaqësuar nga

Thomas T. Prousalis, Jr.



American Capital Group shpk

Donald Shena

Përfaqësuar nga

Thomas T. Prousalis, Jr.

